



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 mars 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së
Shalës dhe Zonës së Karadakut**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 37 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137 dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 korrik 2024, ZPS-ja dorëzoi një mocion për pranimin e dokumenteve ("Mocioni") në lidhje me zonat operative të Shalës dhe Karadakut (përkatësisht "Shtojca 1 e Mocionit" dhe "Shtojca 2 e Mocionit").¹
2. Më 30 gusht 2024, Mbrojtja dorëzoi një përgjigje të përbashkët ndaj Mocionit ("Përgjigja").²
3. Më 9 shtator 2024, ZPS-ja dorëzoi kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes ("Kundërpërgjigja").³

II. PARASHTRIMET

4. ZPS-ja kërkon pranimin e disa dokumenteve të asaj kohe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") në lidhje me zonat operative të Shalës dhe Karadakut ("ZO e Shalës", "ZO e Karadakut" dhe "provat materiale të propozuara").⁴ ZPS-ja parashtron se provat materiale të propozuara: (i) mbështesin dhe plotësojnë prova të dëshmitarëve dhe prova dokumentare dhe

¹ F02468, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut*, 24 korrik 2024, me Shtojcat 1-3, konfidenciale.

² F02521, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut*, 30 gusht 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale (version i korrigjuar u dorëzua më 3 shtator 2024, F02521/COR).

³ F02539, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë në lidhje me Mocionin e Saj për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Shalës dhe Zonës së Karadakut (F02468)*, 9 shtator 2024.

⁴ Mocioni, para. 1, 20, që i referohet Shtojcave 1 dhe 2 të Mocionit.

faktet e shqyrtuara në procese të tjera;⁵ (ii) janë relevante⁶ dhe autentike *prima facie*;⁷ dhe (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet nga efekti dëmtues i tyre.⁸

5. Mbrojtja përgjigjet se ZPS-ja nuk e përmbushi detyrimin e saj për të paraqitur vetëm materiale me vlerë të lartë provuese për t'u pranuar si prova.⁹ Mbrojtja parashtron se mbështetja e theksuar e ZPS-së në paraqitjen në masë të provave jogojore është shkaku kryesor i masës voluminoze të provave dhe ngre shqetësimin që kjo masë mund të ndikojë negativisht në kryerjen me drejtësi të këtij procesi dhe të pengojë thjeshtimin e procedurave.¹⁰ Gjithashtu, Mbrojtja kundërshton pranimin e provave materiale të propozuara¹¹ sepse ato: (i) nuk kanë relevancë të qartë;¹² (ii) atyre u mungon autenticiteti *prima facie* dhe ai duhet të verifikohet përmes dëshmitarëve;¹³ dhe (iii) vlerat provuese të tyre zhbëhen prej efektit dëmtues të tyre.¹⁴ Në veçanti, Mbrojtja mbështetet në të njëjtat kategori kundërshtimesh që ka shprehur edhe më parë,¹⁵ dhe argumenton se: (i) disa dokumente praktikisht nuk përmbajnë asnjë tregues autenticiteti dhe, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së, një përmbledhje dokumentesh, autenticiteti i të cilave është konfirmuar dobët ose nuk është konfirmuar, nuk mund të shërbejë për të vërtetuar autenticitetin e një dokumenti tjetër që ka të njëjtat mangësi;¹⁶ (ii) provat materiale të propozuara përmbajnë “përmbledhje” të gjata dokumentesh, që ndonjëherë nuk kanë lidhje të qartë me njëra-tjetrën;¹⁷ (iii) Trupi Gjykues duhet të marrë parasysh kundërshtimet e mëparshme të

⁵ Mocioni, para. 2.

⁶ Mocioni, para. 1, 3-14. *Shih gjithashtu* Shtojcat 1 dhe 2 të Mocionit.

⁷ Mocioni, para. 1, 15-17. *Shih gjithashtu* Shtojcat 1 dhe 2 të Mocionit.

⁸ Mocioni, para. 1, 18. *Shih gjithashtu* Shtojcat 1 dhe 2 të Mocionit.

⁹ Përgjigja, para. 1.

¹⁰ Përgjigja, para. 1.

¹¹ Përgjigja, para. 1-3, 15.

¹² Përgjigja, para. 8-10. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 2-40; Shtojcën 2 të Përgjigjes, f. 2-18.

¹³ Përgjigja, para. 4-7. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 2-40; Shtojcën 2 të Përgjigjes, f. 2-18.

¹⁴ Përgjigja, para. 11-13. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 2-40; Shtojcën 2 të Përgjigjes, f. 2-18.

¹⁵ Përgjigja, para. 3 që i referohet F01387/A07, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 7 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 21 mars 2023, konfidenciale.

¹⁶ Përgjigja, para. 4-6.

¹⁷ Përgjigja, para. 4.

Mbrojtjes në lidhje me provat materiale të propozuara që u sekuestruan në banesën e z. Selimi;¹⁸ (iv) disa prova materiale të propozuara, në mungesë të dëshmimeve që qartësojnë më tej kontekstin, kanë vetëm lidhje të dobët me faktet dhe rrethanat e pretenduara në Aktakuzë;¹⁹ (v) ZPS-ja përpiqet të provojë relevancën e një dokumenti bazuar në deduksione;²⁰ (vi) pranimi i provave materiale të propozuara do ta dëmtojë Mbrojtjen sepse ZPS-ja nuk ka identifikuar dëshmitarët konkretë përmes të cilëve Mbrojtja do mundej të kundërshtonte përmbajtjen e këtyre dokumenteve;²¹ dhe (vii) ZPS-ja nuk ka dhënë hollësi për kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të informacionit, veç përshkrimeve të përgjithshme se burimi i tyre ishte TPNJ/MPNTP, ose autoritetet shtetërore.²²

6. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja keqinterpreton Mocionin dhe përsërit kundërshtime të mëparshme për një kategori të gjerë provash tashmë të shqyrtuara dhe të hedhura poshtë nga Trupi Gjykses.²³ ZPS-ja argumenton se nuk ekziston asnjë kusht që dokumentet të paraqiten si prova përmes dëshmitarëve dhe se pranimi i dokumenteve si prova jогоjore nuk ka në vetvete efekt dëmtues.²⁴ ZPS-ja parashtro se provat materiale të propozuara duhen shqyrtuar në tërësi, në kuadër të të gjithë informacionit dhe provave relevante.²⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Dispozitat ligjore relevante për aspektin në diskutim përcaktohen, në veçanti, në nenin 40(6)(h) dhe rregullën 138(1), dhe shtjellohen gjerësisht në vendimet e

¹⁸ Përgjigjja, para. 5.

¹⁹ Përgjigjja, para. 8.

²⁰ Përgjigjja, para. 9.

²¹ Përgjigjja, para. 7, 11-12.

²² Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorive A.3, A.3.2 dhe A3.3.

²³ Kundërpërgjigjja, para. 1, 5.

²⁴ Kundërpërgjigjja, para. 2.

²⁵ Kundërpërgjigjja, para. 4.

mëparshme të Trupit Gjykses.²⁶ Trupi Gjykses do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

8. Së pari, Trupi Gjykses vëren se në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara nuk ka asnjë kusht se është e domosdoshme që autenticiteti i provave materiale të propozuara të verifikohet përmes dëshmitarëve.²⁷ Po kështu, nuk ka asnjë pengesë për pranimin si prova jogojore të provave materiale të propozuara, bazuar në rëndësinë thelbësore që ato kanë sipas Prokurorisë për provat dhe argumentet e saj.²⁸ Të njëjtat kushte dhe kritere për pranimin e provave të përcaktuara në rregullën 138(1), vlejné për të gjitha llojet e provave materialeve të propozuara, pavarësisht nga rëndësia (e perceptuar) e tyre për argumentet e një pale.²⁹ E rëndësishme është që pala paraqitëse të bindë Trupin Gjykses se materiali i paraqitur ka relevancë, autenticitet dhe vlerë provuese *prima facie* në bazë të rregullës 138(1). Megjithatë, Trupi Gjykses rikujton se mocionet për provat jogojore nuk duhen përdorur si një mënyrë për ta bërë jorelevant parimin e paraqitjes së dëshmive gojore për procesin. Megjithëse procedura e paraqitjes së provave jogojore i shërben efikasitetit gjyqësor, ajo nuk duhet jetë alternativë për

²⁶ *Shih, p.sh.* F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore* ("Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore"), 31 mars 2023, konfidencial, para. 8-13.

²⁷ *Shih* Vendimin mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 12. *Shih gjithashtu* rregullën 138(1). *Contra* Përgjigjja, para. 2, 7; Shtojca 1 e Përgjigjes, Provat Materiale të Propozuara 1, 3-6, 8-10, 12, 15, 17-19; Shtojca 2 e Përgjigjes, Provat Materiale të Propozuara 6-7, 9.

²⁸ F01596, Trupi Gjykses, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore* ("Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore"), 9 qershor 2023, konfidencial dhe *ex parte*, para. 84 (versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më të njëjtën ditë, F01596/CONF/RED; shënimi *ex parte* në vendim u hoq më 22 qershor 2023, F01596/CONF; vendimi u riklasifikua si publik më 15 nëntor 2023, F01596). *Contra* Përgjigjja, para. 11-12; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorisë R.3.

²⁹ F01983, Trupi Gjykses, *Vendimi i Gjashtë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 5 dhjetor 2023, para. 92.

paraqitjen e provave materiale më të rëndësishme përmes dëshmitarëve që janë në gjendje të flasin dhe mund të merren në pyetje nga pala kundërshtare. Edhe kur një provë materiale e propozuar pranohet si provë jogojore, pala paraqitëse duhet të shohë mundësinë e përdorimit të saj në gjykim me dëshmitarë relevantë, kur kjo shërben për ta kuptuar më mirë dokumentin ose vendin e tij në provat e palës paraqitëse.³⁰ Gjithashtu, përdorimi i provave materiale të propozuara gjatë dëshmisë së dëshmitarëve mund të japë kontekst të vlefshëm që është relevant, për shembull, për peshën dhe mbështetshmërinë e provës materiale.³¹

9. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton se kur vlerësohen mbështetshmëria dhe autenticiteti *prima facie* i një dokumenti të paraqitur sipas rregullës 138(1), nuk kërkohet provë për prejardhjen apo autorësinë e tij, sepse një provë e tillë ka lidhje me peshën provuese të materialeve të paraqitura dhe jo me pranueshmërinë e tyre dhe, si e tillë, do të vlerësohet si duhet nga Trupi Gjykses në fund të gjykimit, duke marrë në konsideratë tërësinë e provave.³² Megjithatë, Trupi Gjykses rikujton se dokumente të shkruara me dorë, që nuk kanë asnjë tregues të emrit të burimit të tyre ose që nuk janë verifikuar ende, shpesh konsiderohen se u mungojnë treguesit e domosdoshëm të mbështetshmërisë, përveç nëse përmbajnë tregues të tjerë relevantë për mbështetshmërinë në to.³³

10. Trupi Gjykses është i mendimit se fakti që materialet e paraqitura ofrohen si pjesë të përmbledhjeve të gjata me dokumente dhe ndonjëherë nuk kanë asnjë lidhje të dukshme me njëri-tjetrin, nuk përbën pengesë për pranimin e tyre, me

³⁰ Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 16.

³¹ Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 17.

³² Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 82. *Contra* Përgjigjja, para. 6, 12; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorisë A1.4; Shtojca 2 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorisë A1.4.

³³ Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 59.

kusht që secili material i paraqitur konstatohet *prima facie* si relevant, autentik, provues dhe nuk i shkakton dëm të panevojshëm Mbrojtjes.³⁴

11. Gjithashtu, Trupi Gjykues është i mendimit se kur disa pjesë të provave materiale të propozuara janë të palexueshme ose të grisura, kjo nuk ndikon pranueshmërinë e tyre nëse pjesët me rëndësi materiale të dokumentit në të cilat mbështetet pala parashtruese nuk janë të dëmtuara dhe i japin mundësi Trupit Gjykues të vlerësojë si duhet relevancën, autenticitetin dhe vlerën provuese të materialit.³⁵

12. Në lidhje me parashtrimin e Mbrojtjes se ZPS-ja nuk jep të dhëna për kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të materialit të paraqitur,³⁶ Trupi Gjykues rikujton konstatimin e tij të mëparshëm se vërtetimi apo dokumentimi i mbajtjes në ruajtje nuk është kusht për pranimin e provave.³⁷

13. Në lidhje me kundërshtimin e Mbrojtjes për provat materiale të propozuara që u sekuestruan nga banesa e z. Selimi,³⁸ Trupi Gjykues rikujton konstatimin e tij në Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore në lidhje me ligjshmërinë e procedurave të kontrollimit dhe të sekuestrimit, i cili u konfirmua nga Paneli i Gjykatës së Apelit.³⁹

14. Tani Trupi Gjykues do të trajtojë argumentin se Mbrojtja do të dëmtohet nga pranimi i provave materiale të propozuara, sepse ZPS-ja nuk ka identifikuar dëshmitarët konkretë përmes të cilëve Mbrojtja do të ketë mundësinë të

³⁴ F02951, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Llapit dhe Kërkesa në lidhje me Të*, 21 shkurt 2025, para. 24. *Contra* Përgjigjja, para. 4; Shtojca 1 e Përgjigjes, Provat Materiale të Propozuara 1, 5, 10, 16.

³⁵ F01716, Trupi Gjykues, *Vendimi i Katërt mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 8 gusht 2023, konfidencial, para. 83.

³⁶ Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorive A.3, A.3.2 dhe A3.3.

³⁷ Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 109.

³⁸ Përgjigjja, para. 5.

³⁹ Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 101-120; IA029/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Veselit dhe Krasniqit kundër Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 23 gusht 2023, konfidencial dhe *ex parte*, para. 32, 36-38 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, IA029/F00005/RED).

kundërshtojë përmbajtjen e këtyre dokumenteve.⁴⁰ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se e drejta e ballafaqimit nuk përfshin edhe të drejtën që pala t'i ketë të gjitha provat materiale ose dokumentet e paraqitura përmes një dëshmitari të cilit ajo ka mundësinë t'i bëjë pyetje në lidhje me përmbajtjen e tyre. Megjithatë, në qoftë se dëshmitarët të cilët mundën të japin kontekst për provat materiale të propozuara nuk pyeten në lidhje me to, kjo mund të ndikojë negativisht në peshën që Trupi Gjykses do të vendosë t'u japë atyre në fund të gjykimit.⁴¹

15. Mbrojtja pretendon gjithashtu se ZPS-ja vazhdimisht u referohet materialeve që nuk janë paraqitur për t'u pranuar si prova, për të mbështetur vërtetimin e autenticitetit të provave materiale të propozuara.⁴² Trupi Gjykses ka theksuar vazhdimisht se nuk do të bazohet në materiale që nuk janë pranuar ose që nuk janë paraqitur për t'u pranuar si prova për të vendosur mbi pranimin e materialeve të tjera.⁴³ Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton se, që një material të pranohet si provë jogojore, ai duhet të plotësojë të gjithë kriteret e rregullës 138(1).⁴⁴ Konfirmimi përmes krahasimit me dokumentet e tjera mund të ndihmojë për të vërtetuar përmbushjen e këtyre kriterëve, por nuk përbën në vetvete kriter pranimi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse provat materiale të propozuara i përmbushin *prima facie* kriteret e rregullës 138(1).

16. Trupi Gjykses tani do të vlerësojë nëse provat materiale të propozuara janë të pranueshme sipas rregullës 138. Në këtë vlerësim, ai do t'u referohet provave materiale të propozuara sipas numërtimit të tyre në Shtojcat 1 dhe 2 të Mocionit dhe Shtojcat 1 dhe 2 të Përgjigjes.

⁴⁰ Përgjigja, para. 11.

⁴¹ *Shih* rregulla 139(2); *Shih për shembull*, Vendimin e Dytë mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 178.

⁴² Përgjigja, para. 5.

⁴³ F01603, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155*, 14 qershor 2023, konfidencial, para. 50 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 shtator 2023, F01603/RED); F02967, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Drenicës*, 26 shkurt 2025, konfidencial, para. 10 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02967/RED).

⁴⁴ Vendimi mbi Mocionin e Provave Jogojore, para. 9.

B. PROVAT MATERIALE TË PROPOZUARA 1-28: DOKUMENTET E ZO TË SHALËS

(a) Relevanca

17. Në lidhje me provat materiale të propozuara 1-28 në Shtojcën 1 të Mocionit, Trupi Gjykses vëren se: (i) provat materiale të propozuara 1-4 përbëhen nga dokumente me lista ushtarësh, plane stërvitore dhe një kërkesë për të marrë pjesë në stërvitjen e një njësie speciale;⁴⁵ (ii) prova materiale e propozuar 5 përbëhet nga rregullorja e shërbimit në UÇK;⁴⁶ (iii) prova materiale e propozuar 6 përbëhet nga disa leje për dhënie benzine dhe naftë; (iv) provat materiale të propozuara 7 dhe 11-12 përbëhen nga orare të shërbimit të rojave dhe të kujdestarisë për oficerët; (v) prova materiale e propozuar 8 përbëhet nga një dokument i Shtabit Operativ të UÇK-së të Çiçavicës, me një listë me emrat e personave që do të shkonin për të marrë armë në Gllogjan; (vi) provat materiale të propozuara 9 dhe 23 përbëhen nga urdhra të UÇK-së për çështje ushtarake të komandantit të ZO të Shalës dhe urdhra për çështje civile të komandantit të shtabit të nënzonës së Çiçavicës; (vii) provat materiale të propozuara 10, 17-18, 20-22 dhe 25 përbëhen nga shënime, raporte, ditarë dhe faqe të një blloku shënimesh, të shkruara me dorë ose të daktilografuara;⁴⁷ (viii) prova materiale e propozuar 13 përbëhet nga një fjalim i shkruar me dorë për zëvendëskomandantin e logjistikës të ZO të Shalës; (ix) prova materiale e propozuar 14 përbëhet nga një dokument i UÇK-së i nënshkruar nga një komandant që jep autorizim për kryerjen e riparimeve; (x) prova materiale e

⁴⁵ Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk paraqet faqen 096543 të provës materiale të propozuar 1 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit f. 2 (prova materiale e propozuar 1). Gjithashtu Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja paraqet vetëm faqet U000-8859-U000-8860 të provës materiale të propozuar 2 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 2 (prova materiale e propozuar 2).

⁴⁶ Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk paraqet faqet 096801-096802 të provës materiale të propozuar 5 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit f. 10 (prova materiale e propozuar 5).

⁴⁷ Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja paraqet vetëm faqet SITF00285699-SITF00285700 të provës materiale të propozuar 17 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 29 (prova materiale e propozuar 17). Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja paraqet vetëm faqet SITF00285777-SITF00285778 të provës materiale të propozuar 18 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 31 (prova materiale e propozuar 18). Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja paraqet vetëm faqen SITF00285702 të provës materiale të propozuar 25 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 38 (prova materiale e propozuar 25).

propozuar 15 është fotografi e deklaratës së një ushtari që pranon t'i bashkohet UÇK-së; (xi) prova materiale e propozuar 16 përbëhet nga një listë emrash të anëtarëve të batalioneve të Brigadës Mehe UKA dhe një listë shtëpish të djegura; (xii) prova materiale e propozuar 19 është një kërkesë e Brigadës 141 Mehe UKA për të holla, drejtuar komandantit të ZO të Shalës; (xiii) prova materiale e propozuar 28 përbëhet nga kërkesa e një anëtari të UÇK-së drejtuar komandantit të ZO të Shalës që të mbetet oficer i UÇK-së; (xiv) prova materiale e propozuar 24 përbëhet nga një leje udhëtimi lëshuar nga shtabi i batalionit të katërt të Brigadës 141; dhe provat materiale të propozuara 26-27 përbëhen nga lista të policisë ushtarake të UÇK-së.

18. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara që kanë lidhje me ZO të Shalës për të treguar, ndër të tjera, se UÇK-ja: (i) regjistron dhe stërviste ushtarë; (ii) organizonte orare të shërbimit të oficerëve dhe rojave; (iii) kontrollonte lëvizjet, përfshirë edhe në postblloqe; (iv) vendoste rregullat e disiplinës dhe merrte masa disiplinore; (v) mblidhte të dhëna për dhe përpilonte lista të “personave në kërkim”.⁴⁸ Gjithashtu, ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara për të treguar: (i) autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm; (ii) strukturën e UÇK-së; (iii) logjistikën; (iv) masat disiplinore të UÇK-së; (v) përgjegjësinë penale për krimet;⁴⁹ dhe që (vi) personat “e dyshimtë” dhe ata që shiheshin si armiq, u vunë në shënjestër, arrestuan, u ndaluan dhe keqtrajtuuan në vende të ndryshme të ZO të Shalës, përfshirë disa që u transferuan në zona operative të tjera.⁵⁰

19. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave materiale të propozuara 1-28, Trupi Gjykues është bindur se ato janë mjaftueshëm të lidhura me faktet dhe rrethanat

⁴⁸ Mocioni, para. 5.

⁴⁹ Mocioni, para. 6.

⁵⁰ Mocioni, para. 7.

që kanë të bëjnë me akuzat në Aktakuzë.⁵¹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 1-28 janë relevante.

(b) Autenticiteti

20. ZPS-ja nuk ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të provave materiale të propozuara 13 dhe 17-18. Trupi Gjykses konstaton se: (i) prova materiale e propozuar 13 nuk ka nënshkrim, datë dhe vulë; nuk dihet se ku, kur dhe nga kush u përpilua dokumenti; thjesht fakti që një dokument i caktuar i pranuar si provë përputhet me një aspekt të provës materiale të propozuar nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të vërtetuar autenticitetin *prima facie*; dhe (ii) megjithëse provat materiale të propozuara 17-18 kanë datë, ato nuk janë të nënshkruara dhe vulosura dhe nuk dihet kush i ka hartuar dokumentet; në këto rrethana, thjesht fakti që përmbajtjet e provave materiale të propozuara 17 dhe 18 përputhen në disa aspekte me dokumente të tjera nuk mjafton për të përmbushur standardin e kërkuar.

21. Trupi Gjykses është bindur që ZPS-ja ka vërtetuar autenticitetin *prima facie* të provave materiale të propozuara 1-12, 14-16 dhe 19-28. Konkretisht, Trupi Gjykses vëren se këto prova materiale të propozuara: (i) kanë datë, ose shënimet brenda materialit janë me datë;⁵² (ii) janë të nënshkruara, ose disa shënime brenda tyre janë të nënshkruara;⁵³ (iii) përmbajnë emrin e autorit;⁵⁴ (iv) përmbajnë të dhëna personale për autorin;⁵⁵ (v) kanë 'UÇK' të shënuar në krye të faqes;⁵⁶ (vi) kanë

⁵¹ Shih p.sh. F00999/A01, Prokurori i Specializuar, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar ("Aktakuza"), 30 shtator 2022, konfidenciale, para. 18-55; shih edhe F01594/A03, Prokurori i Specializuar, Shtojca 3 e Parashtrimit nga Prokuroria të Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit Konfidencial më Pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake ("Dosja Paraprake e ZPS-së"), 9 qershor 2023, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 3 prill 2023, F01415/A01), para. 220-225, 227. Contra Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorisë R.1.

⁵² Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 1-2, 4-7, 9-10, 14-16, 19-20, 23, 28.

⁵³ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 1-2, 4-12, 14-16, 19-21, 23, 25-27.

⁵⁴ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 3, 20-22, 24, 28.

⁵⁵ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 1, 3.

⁵⁶ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 5-6, 8-12, 16, 23, 26-28.

stemën/simbolin e UÇK-së;⁵⁷ (vii) kanë numër reference;⁵⁸ ose (viii) u sekuestruan nga ZPS-ja në banesën e z. Selimi.⁵⁹

22. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 1-12, 14-16 dhe 19-28 janë autentike *prima facie*.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

23. Me konstatimin e provave materiale të propozuara 1-12, 14-16 dhe 19-28 si relevante dhe autentike *prima facie*, Trupi Gjykses është bindur që këto materiale kanë edhe vlerë provuese *prima facie* për fakte dhe rrethana që kanë lidhje me këtë çështje, sikurse përshkruhet më sipër në paragrafin 18.⁶⁰

24. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e dokumenteve në paragrafin 17 nuk zhbëhet nga ndonjë dëm që mund t'u shkaktohet të akuzuarve, duke pasur parasysh se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë, nëse dëshiron, parashtrime në lidhje me peshën dhe vlerën provuese të këtyre materialeve dhe mund të kundërshtojë përmbajtjen e tyre përmes paraqitjes së provave, ndonëse nuk ka detyrimin ta bëjë këtë.

(d) Përfundim

25. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon provat materiale të propozuara 1-12, 14-16 dhe 19-28 dhe hedh poshtë, pa paragjykuar vendime të ardhshme, pranimin e provave materiale të propozuara 13 dhe 17-18.

C. PROVAT MATERIALE TË PROPOZUARA 1-10: DOKUMENTET E ZO TË KARADAKUT

26. Trupi Gjykses vëren fillimisht se që nga koha e paraqitjes së Mocionit, provat materiale të propozuara 1, 5, 8 dhe 9 nga Shtojca 2 janë pranuar përkatësisht si

⁵⁷ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 6, 20, 22, 24, 28.

⁵⁸ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 19.

⁵⁹ Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 8-9, 18-19.

⁶⁰ *Contra* Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorisë PV.1.

provat P01659, P01522, P01532 dhe P01539. Për këtë arsye, kërkesa për pranimin e këtyre materialeve është e tejkaluar.

(a) Relevanca

27. Në lidhje me provat materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10, Trupi Gjykues vëren se: (i) prova materiale e propozuar 2 përbëhet nga një raport i Ministrisë së Mbrojtjes të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ("QPK"); (ii) prova materiale e propozuar 3 përbëhet nga fatura dhe një vërtetim për dhënie të lejes; (iii) prova materiale e propozuar 4 përbëhet nga formularë të ZO të Karadakut për dhënien e armëve;⁶¹ (iv) provat materiale të propozuara 6 dhe 7 përbëhen nga urdhra të komandantit të ZO të Karadakut;⁶² dhe (v) prova materiale e propozuar 10 përbëhet nga një raport ushtarak i shkruar me dorë me përshkrim të ngjarjeve që ndodhën në ZO të Karadakut në fund të vitit 1999.

28. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja mbështetet në prova materiale të propozuara që kanë lidhje me ZO të Karadakut për të treguar, ndër të tjera, se: (i) probleme organizative, logjistike, etj., që dilnin në ZO të Karadakut i paraqiteshin Shtabit të Përgjithshëm dhe Qeverisë së Përkohshme të Kosovës;⁶³ (ii) ZO e Karadakut bashkëpunonte ngushtë me zonën fqinjë të Llapit;⁶⁴ (iii) në prill 1999, ZO e Karadakut kishte polici ushtarak dhe kishte krijuar Brigadën 171;⁶⁵ (iv) në 19 ose 20 qershor 1999, komanda e ZO të Karadakut filloi të mblidhte armë si nga shqiptarët, ashtu edhe nga serbët, dhe të lëshonte vërtetime;⁶⁶ (v) komandanti i ZO të Karadakut lëshonte urdhra me shkrim për paraqitje të personave në komandën e ZO të Karadakut;⁶⁷ (vi) ZO e Karadakut kontrollonte

⁶¹ Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja paraqet vetëm faqet U001-2019-U001-2020 të provës materiale të propozuar 4 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 2 të Mocionit, f. 7 (prova materiale e propozuar 4).

⁶² Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja paraqet faqen 077980 të provës materiale të propozuar 7 dhe përkthimin përkatës. *Shih* Shtojcën 2 të Mocionit, f. 12 (prova materiale e propozuar 7).

⁶³ Mocioni, para. 9.

⁶⁴ Mocioni, para. 9.

⁶⁵ Mocioni, para. 10.

⁶⁶ Mocioni, para. 11.

⁶⁷ Mocioni, para. 11.

strukturat bashkiake, shërbimet publike, shërbimet komunale dhe administratorët e përkohshëm të QPK-së;⁶⁸ (vii) Ahmet Isufi jepte, ndër të tjera, urdhra që ndalonin marrëveshjet me palën serbe, Forcat e Kosovës të udhëhequra nga NATO (“KFOR”) ose me ndonjë palë tjetër;⁶⁹ (viii) ZO e Karadakut mbante lista, orare dhe materiale për stërvitje, kuponë ushqimorë, dokumente të policisë ushtarake dhe të dhëna për personat që nuk konsideroheshin besnikë të UÇK-së;⁷⁰ (ix) komanda e ZO të Karadakut emëronte komandantët dhe caktonte vendet për takimet në ilegalitet të UÇK-së, stacionet e policisë dhe bazat në zonat që i kishte në kontroll;⁷¹ (x) në periudhën nga mesi i qershorit deri në fund të korrikut 1999, anëtarët e UÇK-së në këto vende vinin në shënjestër, arrestonin, keqtrajtonin dhe vrisnin bashkëpunëtorë të pretenduar dhe persona të tjerë që shiheshin si kundërshtarë, përfshirë edhe viktimat e përmendura në Aktakuzë në këtë çështje;⁷² dhe (xi) komandanti i policisë ushtarake të ZO të Karadakut i raportoi Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Rendit Publik të QPK-së për një bastisje në fjetoren e KFOR-it në Gjilan dhe arrestimin e ushtarëve të UÇK-së.⁷³

29. Pasi ka shqyrtuar me kujdes provat materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10, Trupi Gjykses është bindur se ato kanë lidhje të mjaftueshme me faktet dhe rrethanat e paraqitura në Aktakuzë.⁷⁴ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10 janë relevante *prima facie*.

(b) Autenticiteti

30. Trupi Gjykses është bindur për autenticitetin *prima facie* të provave materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10. Konkretisht, Trupi Gjykses vëren se provat

⁶⁸ Mocioni, para. 11.

⁶⁹ Mocioni, para. 11.

⁷⁰ Mocioni, para. 11.

⁷¹ Mocioni, para. 12.

⁷² Mocioni, para. 12.

⁷³ Mocioni, para. 14.

⁷⁴ *Shih p.sh.* Aktakuza, para. 18-55, 86, 92, 94, 124, 133, 135, 172. *Shih gjithashtu* Dosjen Paraprake të ZPS-së, para. 251-259. *Contra* Shtojca 2 e Përgjigjes, kundërshtimet ndaj kategorisë R.1.

materiale të propozuara: (i) kanë datë;⁷⁵ (ii) janë të nënshkruara, ose disa shënime në to janë të nënshkruara;⁷⁶ (iii) përmbajnë emrin e autorit;⁷⁷ (iv) kanë të shënuar emrin e UÇK-së në krye të faqes;⁷⁸ (v) kanë stemën/simbolin e UÇK-së;⁷⁹ (vi) kanë numër reference;⁸⁰ u sekuestruan nga ZPS-ja në banesën e z. Selimi.⁸¹

31. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10 janë autentike *prima facie*.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

32. Pasi i ka konstatuar provat materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10 si relevante dhe autentike *prima facie*, Trupi Gjykses është bindur që këto materiale kanë vlerë provuese *prima facie* për fakte dhe rrethana që kanë lidhje me këtë çështje, sikurse përshkruhet më sipër në paragrafin 28.

33. Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese *prima facie* e dokumenteve në paragrafin 27 nuk zhbëhet nga ndonjë dëm që mund t'u shkaktohet të akuzuarve, duke pasur parasysh se Mbrojtja do të ketë mundësinë të bëjë parashtrime lidhur me peshën dhe vlerën provuese të këtyre materialeve dhe mund të kundërshtojë përmbajtjen e tyre, nëse dëshiron, përmes paraqitjes së provave, ndonëse nuk ka detyrimin ta bëjë këtë.

(d) Përfundim

34. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses pranon provat materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10.

⁷⁵ Shtojca 2 e Mocionit, provat materiale të propozuara 41-3, 5-8, 10.

⁷⁶ Shtojca 2 e Mocionit, provat materiale të propozuara 2-3, 7, 10.

⁷⁷ Shtojca 2 e Mocionit, prova materiale e propozuar 6.

⁷⁸ Shtojca 2 e Mocionit, provat materiale të propozuara 3-4, 6-7.

⁷⁹ Shtojca 2 e Mocionit, provat materiale të propozuara 3, 6-7.

⁸⁰ Shtojca 2 e Mocionit, provat materiale të propozuara 3, 5-7.

⁸¹ Shtojca 2 e Mocionit, prova materiale e propozuar 10.

V. KLASIFIKIMI

35. Trupi Gjykses udhëzon Administratoren që materialet e pranuara t'i klasifikojë sipas përcaktimeve në Shtojcat 1 dhe 2 të Mocionit.

VI. VENDIM

36. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** pjesërisht Mocionin;
- b) **PRANON** provat materiale të propozuara 1-12, 14-16 dhe 19-28 nga Shtojca 1 e Mocionit dhe provat materiale të propozuara 2-4, 6-7 dhe 10 nga Shtojca 2 e Mocionit, bashkë me përkthimet përkatëse;
- c) **HEDH POSHTË**, pa paragjykuar vendime të ardhshme, pranimin e provave materiale të propozuara 13 dhe 17-18 nga Shtojca 1 e Mocionit;
- d) **DEKLARON** të tejkaluar kërkesën për pranimin e provave materiale të propozuara 1, 5 dhe 8-9 nga Shtojca 2 e Mocionit; dhe
- e) **UDHËZON** Administratoren t'u caktojë materialeve të pranuara: (i) numra të provës materiale; dhe (ii) klasifikimin sipas përcaktimeve në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 të Mocionit.

_____/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 4 mars 2025

Në Hagë, Holandë.